

DEKLARIMI DHE VERIFIKIMI I PASURISË SË ZYRTARËVE TË LARTË ZBATIMI I LIGJIT MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

PRILL 2008-DHJETOR 2008

Raporti i përgaditur nga “watch dog” në përbërje të Qendrës për Transparencë dhe Informim të Lirë përfshin kontrollin e deklarimeve të pasurisë dhe konfliktit të interesit për zyrtarët e sistemit të drejtësisë, konkretisht gjyqtarëve në të gjitha shkallët e gjyqësorit dhe prokurorëve. Po ashtu përfshin investigimin mbi pasuritë e këtyre zyrtarëve dhe konfliktin e interesit si dhe ka matur indikatorë të tjerë jashtë deklaratës së pasurisë për të përshkruar perceptime shtesë lidhur me situatën ligjore të zyrtarëve të mësipërm.

Të dhënat e mbledhura janë përpunuar duke dhënë përgjigje disa pyetjeve themelore përmes të cilave sigurohet edhe një përgjigje rreth zbatimit të dy ligjeve.

“Watch Dog”, në përbërje të Qendrës për Transparencë dhe Informimin e Lirë, ka seleksionuar me zgjedhje të lirë rreth 5 për qind të zyrtarëve të drejtësisë dhe vetëm në katër raste është përdorur seleksionimi i përzgjedhur për shkak të detyrave që mbajnë zyrtarët.

Anëtarët e “Watch Dog” janë gazetarë, juristë, vlerësues pasurie dhe avokatë të çështjeve civile. Investigimi është zhvilluar përgjatë tetë muajve, duke filluar në prillin e 2008-s deri në fund të dhjetorit të 2008-s.

Subjekte të zbatimit të ligjeve të mësipërm janë rreth 4500 zyrtarë të lartë apo të mesëm të administratës shqiptare ndër ta 646 gjykatës dhe prokurorë. Ata janë të detyruar të deklarojnë pasuritë e tyre, si dhe pozicionin që ata kanë në raport me detyrën që kryejnë në administratën publike. Ligji për deklarimin e pasurive të zyrtarëve të lartë miratuar nga parlamenti në vitin 2003, dhe ai mbi konfliktin e interesit miratuar në vitin 2005, synojnë kontrollin e pavarur mbi administratën, kufizimin dhe identifikimin e mundshëm të rasteve të fshehjes së pasurive apo konfliktit të interesit të zyrtarëve të lartë.

Projekti është mbështetur nga Ambasada Britanike në Tiranë .